



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 4

Nëntor 2017

SHTYLLA IV BASHKIMI EUROPIAN DHE INTEGRIMI

Rasti i Facebook-ut dhe zhvillimet e fundit të legjislacionit European mbi shkeljet e procedurave të bashkimit /përqendrimit të shoqërive¹

Nga Dr. Nora Memeti

Asistente Professore e të Drejtës Tregtare, në Kuwait International Law School

I. ABSTRAKT

Më 18 Maj 2017 Komisioni European shqyrtoi rastin e Facebook-ut (FB) në kuadër të shkeljes së rregullave procedurale të bashkimit/përqendrimit të shoqërive të përcaktuara nga Rregullorja Europiane e Bashkimit të Shoqërive (ECMR) në lidhje me dhënien e informacioneve të pasakta ose mashtruese. Facebook-u mori një gjobë prej 110 milion Euro për shkak të shkeljes së rregullave procedurale të ECMR-së në dhënien e informacioneve të pasakta ose mashtruese gjatë blerjes së Whatsapp-it. Ky shkrim trajton në mënyrë të detajuar këtë rast në kuadër të legjislacioni European të Bashkimit të Shoqërive. Së pari, jepet një pamje e përgjithshme e Rregullores Europiane të Bashkimit të Shoqërive. Së dyti, përshkruhen dispozitat kryesore të cilat përcaktojnë rregullat procedurale Europiane të bashkimit të shoqërive në lidhje me informacionet mashtruese dhe zhvillimet e fundit në këtë fushë si pasojë e rastit të Facebook-ut. Shoqëritë tregtare, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e brendshëm të BE-së, duhet të jenë të vetëdijshme se ato kanë detyrimin thelbësor të respektojnë rregullat Europiane të bashkimit të shoqërive në rastin kur kryejnë procedurat e bashkimit. Për më tepër këto rregulla kanë gjithashtu ndikim edhe për vendet Kandidate të tilla si Shqipëria dhe Maqedonia të cilat duhet të harmonizojnë legjislacionin e tyre të brendshëm, përfshirë legjislacionin dhe politikat shtetërore mbi konkurrencën, me legjislacionin e BE-së. Këto ndikime ndaj Shqipërisë dhe Maqedonisë do të trajtohen gjithashtu në kuadër të zhvillimeve të fundit në legjislacionin European të konkurrencës si pasojë e rastit të Facebook-ut.

FJALË KYÇE: FB, Whatsapp, ECMR, kontroll i bashkimit të shoqërive, shkelje procedurale, informacion mashtrues

SHKURTIME:

ACQUIS

EU Acquis / Acquis Communautaire

AKK

Autoritetet Kombëtare të Konkurrencës

ASHK

Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës

BE

Bashkimi European

¹ Për qëllim të këtij shkrimi termat ‘bashkim i shoqërive’ dhe ‘përqëndrim’ përdoren me të njëjtin kuptim dhe i referohen rregullave procedurale europiane të përqendrimeve.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL ♦ Numri 4 Nëntor 2017

ECMR	Rregullorja Europiane e Bashkimit të Shoqërive
FB	Facebook Inc.
GJD	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European
KE	Komuniteti European
Komisioni	Komisioni European
LMKM	Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës në Maqedoni, Gazeta Zyrtare 145/10, Republika e Maqedonisë
LMKSh	Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës në Shqipëri Nr. 9121, Datë 28.07.2003
SHKK	Shërbimet e Komunikimit të Konsumatorit
SHRO	Shërbimet e Reklamave Online
SHRRS	Shërbimet e Rrjeteve Sociale
TBE	Traktati i Bashkimit European
TFBE	Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit European

II. HYRJE

Ndërsa Komisioni European (Komisioni) ishte shumë aktiv në zbatimin e rregullave procedurale Europiane të përcaktuara nga Rregullorja Europiane e Bashkimit të Shoqërive (ECMR), nuk mbeteshin mbrapa në këtë drejtim as disa nga Autoritetet Kombëtare të Konkurrencës (AKK) të vendeve të zhvilluara, anëtare të BE-së². Në emër të Komisionit, Komisionerja Europiane për Konkurrencën, Vestager, trajtoi çështjen e Facebook-ut si shembull të shkeljes nga shoqëritë, të rregullave të kontrollit të bashkimit të shoqërive.³ Mbikëqyrësi European gjobiti Facebook-un për dhënien e informacioneve të pasakta apo mashtruese.

Sigurisht që rregullat në lidhje me informacionin e pasaktë apo mashtrues nuk përcaktohen vetëm nga legjislacioni European për bashkimin e shoqërive, megjithatë ky shkrim do të analizojë shkeljen e këtyre rregullave vetëm në këtë kontekst. Në këtë kuadër do të trajtohen gjithashtu shkurtimisht rregullat e bashkimit të Shoqërive të zbatuara në Shqipëri dhe në Maqedoni.⁴ Kjo veçanërisht në aspektin se si ndikohen këto dy vende Kandidate të BE-së dhe

² Komisionerja Europiane e tanishme ka theksuar që gjopa më e fundit nuk lidhet më hetimet kombëtare të antitrusteve. Investigimi gjerman u realizua në kuadër të abuzimit me pozitën dominuese të FB-së, i cili dështoi nëinformimin e konsumatorëve se si të dhënat e tyre personale janë duke u përdorur. Mbikëqyrësi Franceze ka gjobitur FB-në me 150,000 €, pasi ky i fundit dështoi të parandalonte përdorimin e të dhënave personale të konsumatorëve nga reklamuesit. Ndërkohë po zhvillohen hetime edhe në tre vende të tjera anëtare të BE-së si: Belgjika, Holanda dhe Spanja. Komisionerja Europiane për Konkurrencën, Vestager ka theksuar se ajo po i vëzhgon nga afër dhe me kujdes të veçantë rezultatet e hetimeve nga autoritetet gjermane dhe të tjerët, teksa vuri në dukje se ‘ në legjislacionin tonë ti mund të kesh pozitë dominuese pa pasur nevojë të shkelësh ndonjë rregull – Neni 102 i TFBE-sw.”

³ Shih Qëndrimin e Komisioneres Vestager, Bruksel, 17 Maj 2017, i aksesueshëm në: http://europa.eu/rapid/press-release_Statement-17-1367_en.htm.

⁴Anastasakis, Othon, dhe Dimitar Bechev. "EU conditionality in South East Europe: bringing commitment to the process." Programi i Studimeve i Evropës Juglindore (2003): 1-20.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL

◆ Numri 4

Nëntor 2017

përse vendimi mbi rastin e Facebook-ut ka rëndësi për to, duke pasur parasysh se të dy vendet kanë detyrimin të përafrojnë legjislacionin e tyre të brendshëm, përfshirë politikat në fushën e konkurrencës, me ‘*Acquis Communautaire*’ (*Acquis*)⁵.

III. RREGULLAT EUROPIANE TË BASHKIMIT TË SHOQËRIVE

Bashkimi i shoqërive është një nga tre shtyllat kryesore të të Drejtës së Konkurrencës të Bashkimit European. E drejta e konkurrencës përbëhet nga rregulla që kanë për qëllim të mbrojnë procesin e konkurrencës dhe të rrisin mirëqenien e konsumatorit.⁶

Rregullat Europiane për kontrollin e bashkimit të shoqërive e kanë prejardhjen nga dy nenet 101 dhe 102 të TFBE-së, më parë të njohura si nenet 85⁷ dhe 86⁸ të Traktatit. Nëpërmjet këtyre dy neneve Komisioni dhe Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European (GJD) kryenin kontrollin e procedurave të përqendrimit brenda BE-së. Megjithatë kur u miratua rregullorja e bashkimit të shoqërive, legjislatori vlerësoi se koncepti i “*krijimit apo fuqizimit të një pozite dominuese*”, i cili rrjedh nga Neni 86 i Traktatit (Neni 106 TFBE), përbënte një bazë më të përshtatshme për kryerjen e vlerësimit thelbësor të kontrollit të bashkimit të shoqërive.⁹

Bazë ligjore për miratimin e ECMR-së janë Nenet 103 dhe 353 të TFBE-së. Megjithatë nuk ka dispozita të legjislacionit primar (traktateve) në lidhje me kontrollin e bashkimit të shoqërive.¹⁰ Rregullat për bashkimin e shoqërive u miratuan me anë të Rregullores së Bashkimit të Shoqërive të KE-së në vitin 1989 me qëllimin për të krijuar kushte të barabarta tregu sipas formulës ‘zyrë me një ndalesë’ (one-stop-shop).¹¹ Për të garantuar që tregu i brendshëm i BE-së të funksionojë

⁵ ‘*Acquis Communautaire*’ përfshin të gjithë legjislacionin e BE-së, si traktatet e BE-së, ligjet, vendimet e gjykatave etj.

⁶ Ligjet mbi Konkurrencën janë hartuar me Traktatin e Parisit të vitit 1951. Legjislacioni mbi Konkurrencën ishte një pjesë e rëndësishme e Traktatit që në fillim, dhe sot mund të gjendet në TFBE-në sipas neneve 101 dhe 102. Shtylla e parë (101) përfshin rregullat mbi marrëveshjet anti-konkurrese dhe shtylla e dytë sipas neni 102 përfshin sjelljet abuzive. Shtylla e tretë përfshin bashkimet, temë e trajtuar në këtë artikull. Shih gjithashtu: Versionin përfundimtar të Traktatit të BE-së dhe Traktatit për Funkcionimin e BE-së - Protokollet - Deklaratat e aneksuara në aktet finale të Konferencës Ndërqeveritare që miratuan Traktatin e Lisbonës, nënshkruar më 13 Dhjetor 2007,- Tabelat e ekuivalencave - Fletorja Zyrtare C 326 26/10/2012 P. 0001 – 0390. Shih gjithashtu: Whish, Richard, and David Bailey. *Competition law*. Oxford University Press, USA, 2015, fq. 854-856.

⁷ Vendim i Gjykatës (Dhoma 6) e 17 Nëntorit 1987. *British-American Tobacco Company Ltd and R. J. Reynolds Industries Inc. kundër Komisionit*. – Konkurrenca- Të drejtat e aneksesve – Aksionet në një kompani konkurrese – Cështje të unifikuara 142 dhe 156/84.

⁸ Vendim i Gjykatës i 21 Shkurtit 1973. - *Europemballage Corporation and Continental Can Company Inc. kundër Komisionit* – Cështja 6-72. Komisioni

⁹ Costa-Cabral, Francisco, dhe Orla Lynskey. "The internal and external constraints of data protection on competition law in the EU." *Revista Elektronike SSRN* (2015).

¹⁰ Craig, Paul, dhe Gráinne De Búrca, *EU law: text, cases, and materials*. Oxford University Press, 2015, 1090-2. Shih gjithashtu: Foster, Nigel, *Foster on EU law*. Oxford University Press, USA, 2015, fq. 358-361.

¹¹ As Traktati i Romës, as Akti Gjerman kundër Kufizimeve të Konkurrencës nuk parashikonin rregulla specifike për kontrollimin e bashkimeve, me përjashtim të Neni 66 (1)-(6) të Traktatit të Komunitetit European të Qymyrit dhe Çelikut (KEQÇ) i aksesueshëm në : <http://eur-lex.europa.eu/legal->



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL

◆ Numri 4

Nëntor 2017

më mirë së bashku¹², Komisioni zbaton në mënyrë të drejtpërdrejtë rregullat e BE-së në fushën e konkurrencë, duke vepruar herë veçmas dhe herë bashkarisht me AKK-të¹³. Kjo veprimtari sjell përfitime për konsumatorët, bizneset dhe për ekonominë Europiane në tërësi.¹⁴ Në kontinentin Europian, përveç shteteve anëtare të BE-së, kanë miratuar ligje për mbrojtjen e konkurrencës edhe vendet kandidatë të BE-së, të cilat si pasojë e parakushtit të anëtarësimit¹⁵, janë në një masë të konsiderueshme në linjë me të drejtën europiane të konkurrencës.

Në vitin 1989 u miratua e ashtuquajtura ‘Rregullore origjinale e Bashkimit të Shoqërive’.¹⁶ Kjo rregullore u ndryshua dhe u zëvendësua nga varianti aktual i Rregullores së Bashkimit të Shoqërive, hyrë në fuqi më 1 Maj 2004.¹⁷ Në bazë të ECMR-së përqendrimet mbulojnë rastet e bashkimit të shoqërive, përfitimit të kontrollit dhe krijimit të sipërmarrjeve të përbashkëta me funksion të plotë (joint ventures).¹⁸ Si rregull përqendrimet me dimension Europian shqyrtohen nga Komisioni, ndërsa ato që nuk kanë dimension Europian shqyrtohen nga AKK-të në përputhje

content/EN/TXT/HTML/?uri=LEGISSUM:xy0022&from=EN, i cili parashikonte një kompetencë ekskluzive për Autoritetin e Lartë të KEQÇ pa ndonjë kompetencë të mbetur për Shtetet Anëtare për krijimin e kontrollit kombëtar të bashkimit dhe pa kërkesën për një efekt në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare, Shih gjithashtu: Lianos, I., dhe A. Andreangeli. "The Competition Law System and the Union's norms." Oxford University Press, 2012.

¹² Patel, Kiran Klaus, dhe Heike Schweitzer, eds. *The historical foundations of EU competition law: EU Competition law in historical context: Continuity and Change*, Oxford University Press, 2013, fq. 207-220.

¹³ Arsenidou, Elisavet, Ailsa Sinclair, dhe Jurga Stanciute. "Empowering the national competition authorities to be more effective enforcers." *Ligji i Konkurrencës & Debati i Politikës* 3, nr. 3 (2017): 33-39. Shih gjithashtu: Kaczorowska-Ireland, Alina. *European union law*. Routledge, 2016.

¹⁴ Devenney, James, dhe Mel Kenny, eds, *European consumer protection: theory and practice*. Cambridge University Press, 2012, Christian Twigg-Flessner, *Comment: The future of EU Consumer Law – the end of harmonization?* Fq. 6-20, Shih gjithashtu: Devenney, James, and Mel Kenny, eds. *European consumer protection: theory and practice*. Cambridge University Press, fq. 437-449.

¹⁵ Nxitur nga ndryshimi i bindjeve politike dhe dëshira e mirë për të mundësuar tregun e lirë të funksionojë mirw, sot ka më shumë se 125 sisteme ligjore për Ligjin e konkurrencës në gjithë botën. Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës (ICN) ka 126 anëtare nga 111 juridiksione (Qëndrimi i Kryetarit të Grupit Drejtues, Andreas Mundt, Shtator 2013) Shih gjithashtu: Challenges of International Co-operation in Competition Law Enforcement, OECD Publication, 2014, i aksesueshëm në: <https://www.oecd.org/daf/competition/Challenges-Competition-Internat-Coop-2014.pdf>.

¹⁶ Rregullore e Këshillit (EEC) 4064/89 (OJ 1989 L395/1, 30.12.1989), andryshuar nga Rregullorja e Këshillit (EC) 1310/97 (OJ 1997 L180/1, 9.7.1997; corrigendum OJ 1998 L40/17, 13.2.1998).^[17]

¹⁷ Rregullorja e Këshillit, (EC) 139/2004 (OJ 2004 L24/1, 29.1.2004). OJ L 24, 29.1.2004, fq. 1, Shkurtimi "ECMR" do të përdoret në të gjithë tekstin. Në të njëjtin vit, u miratua Rregullorja e zbatimit, e njohur si Rregullorja e Zbatimit e Rregullores së Komisionit (EC) Nr. 802/2004 e 7 Prillit 2004 që zbaton Rregulloren e Këshillit (EC) No 139/2004 (publikuar në OJ L 133, 30.04.2004, p.1) ndryshuar nga Rregullorja e Komisionit (EC) Nr 1033/2008 i 20 Tetorit 2008 (publikuar në OJ L 279, 22.10.2008, p. 3) – Versioni i Konsoliduar i 23 Tetorit 2008; FHyre në fuqi nga 1 Dhjetori i 2009, TFBE-ja psolli ndryshime të mëdha, siç ishte zëvendësimi i termit "Komunitet" me "Bashkim" dhe "tregut të përbashkët" me "tregun e vetëm". Terminologjia e TFBE-sw do të përdoret në gjithë vendimin.

¹⁸ Inkpen, Andrew C., dhe Steven C. Currall. "The co-evolution of trust, control, and learning in joint ventures." *Organization science* 15, nr. 5 (2004): 586-599. Shih gjithashtu: Cooper, Cary L., dhe Sydney Finkelstein, eds, *Advances in mergers and acquisitions*. Emerald Group Publishing, 2014.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL ♦ Numri 4

Nëntor 2017

me legjislacionin e brendshëm mbi rregullat e kontrollit të bashkimit të shoqërive.¹⁹ Parimisht bashkimet e shoqërive me dimension European duhet t'i njoftohen Komisionit²⁰ dhe nuk duhet të realizohen derisa Komisioni t'i shpallë ato në përputhje me tregun e brendshëm.²¹ Rregullorja zbatuese përcakton format që duhet të përdorin shoqëritë për njoftimin e përqendrimeve tek Komisioni.²²

Siç u përmend, bashkimet e shoqërive brenda BE-së, zakonisht ndodhin kur dy shoqëri vendosin të bashkohen duke krijuar një shoqëri të re²³. Bashkimet horizontale zakonisht ngjallin frikën se mund të krijojnë efekte negative mbi konkurrencën²⁴. Është bashkim horizontal shoqërisht ai që ndodh mes shoqërive që veprojnë në të njëjtin nivel²⁵. Këto lloj bashkimesh konsiderohen si të rrezikshme duke qenë se pas bashkimit pjesa e interesuar e tregut (tregu gjeografik dhe tregu i produktit)²⁶ do të ketë një sipërmarrje më pak. Kjo përkthehet gjithashtu në një ofertë më pak për konsumatorin dhe në një pjesë më të madhe të tregut për shoqërinë e krijuar pas bashkimit²⁷. Në rastin tonë, Facebook-u dhe Whatsappi krijuan një bashkim horizontal duke ofruar

¹⁹ Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, ekzistojnë procedura sipas të cilave palët mund të angazhohen në kontaktet e para-njoftimit me autoritetet me qëllim të rial-shpërndarjen e juridiksionit ndërmjet Komisionit dhe AAK-ve. Procedurat ekzistojnë gjithashtu për pas-njoftimin e ri-shpërndarjes së rasteve ndërmjet Komisionit dhe AAK-ve, dhe në rrethana të caktuara të kufizuara Shtetet Anëtare akoma mund të zbatojnë ligjet e tyre kombëtare në përqendrimet me shtrirjen e BE-së.

²⁰ Drejtoria e Konkurrencës së Komisionit Evropian, me kompetenca mbi konkurrencën në të gjithë Bashkimin Evropian që ushtrohen aktivisht në mënyrë të rregullt. Shih gjithashtu: Finkelstein, Sydney, ed. *Advances in mergers and acquisitions*. Vëlimi. 16. Emerald Group Publishing, 2017.

²¹ Barnard, Catherine. *The substantive law of the EU: the four freedoms*. Oxford University Press, 2013.

²² 'Rregullorja e Zbatimit' e Rregullores së Komisionit (EC) 802/2004 (OJ 2004 L133/1, 30.4.2004), ndryshuar nga Rregullorja e Komisionit (EC) 1033/2008 (OJ 2008 L279/3).

²³ Në Ligjin Evropian të Konkurrencës përdoren të dyja termat si bashkimet, ashtu dhe përqendrimet, edhe pse 'përqendrimet' gjenden te "ECMR". Shih: Martynova, Marina, and Luc Renneboog. "A century of corporate takeovers: what have we learned and where do we stand? (Titulli i mëparshëm: The history of M&A activity around the world: A survey of literature)." (2005), i aksesueshëm në: www.ssrn.com.

²⁴ Ka tre lloje bashkimesh në ligjin e BE-së: përfshirë bashkimin horizontal, vertikal dhe konglomerat. Vetëm bashkimet horizontale do të jenë objekt i studimit në këtë artikull. Shih gjithashtu: Udhëzimet mbi Vlerësimin e Bashkimeve Horizontale: [http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52004XC0205\(02\)&from=EN](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52004XC0205(02)&from=EN). Shih gjithashtu: Fee, C. Edward, dhe Shawn Thomas. "Sources of gains in horizontal mergers: evidence from customer, supplier, and rival firms." *Revista e Ekonomisë Financiare* 74, nr. 3 (2004): 423-460.

²⁵ De Geest, Gerrit dhe Roger J. Van den Bergh. *Comparative law and economics*. Edward Elger Publishing, 2004. Harvard.

²⁶ De Coninck, Raphaël, dhe Mikaël Hervé. "Mergers: How to Measure Local Competition." *Journal of European Competition Law & Practice* (2017): 1-7. Shih gjithashtu: Sheridan, Alexandra. "Is the relevant EU legislation regarding competition law on mergers effective in preventing mergers that result in a dominant market position? Or is the Commission exceeding its competence in its application of legislation causing it to be ineffective in light of relevant case law?" (2016). Pyetja kryesore është nëse një bashkim i caktuar do të rrisë fuqinë e firmave në treg dhe për këtë gjëja e parë për t'u bërë është përcaktimi i tregut, shih: *The Commission's Notice on Market definition and Previous Decisional Practice*, [1997] OJ C372/5.

²⁷ Hovenkamp, Herbert. *Federal Antitrust Policy, The Law of Competition and Its Practice*. West Academic, 2015.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL

Numri 4

Nëntor 2017

aplikacione komunikimi për celularët smart (smart-phone)²⁸. Të dyja sipërmarrjet njoftuan Komisionin dhe morën miratimin e tij. Kjo do të thotë se Komisioni arriti në përfundimin që përqendrimi mes këtyre dy shoqërive nuk përbënte një veprimtari shqetësuese. Nga ana tjetër bashkimi i shoqërive, në përputhje me parashikimet e Nenit 1 të ECMR-së kishte dimension European. Neni 1 i ECMR-së përcakton çfarë përfshihet nën etiketën “*dimension European*” dhe pragjet përkatëse.²⁹ Koncepti i dimensionit European është krijuar me qëllim identifikimin e përqendrimeve të cilat mund të krijojnë ndryshime domethënëse.³⁰ Vlerësimi kryesor gjendet në Nenin 1 (2) të ECMR-së i cili përkufizon konceptin e dimensionit European: Një përqendrim ka dimension european kur: (a) xhiroja totale në nivel botëror³¹ e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse në përqendrim është më e madhe se 5,000 milion Euro dhe (b) xhiroja totale e realizuar në mënyrë individuale në BE nga të paktën dy ndërmarrje pjesëmarrëse në përqendrim është më e madhe se 250 milion Euro, përveç rasteve kur secila nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim krijon më shumë se dy të tretat e xhiros totale në BE, brenda vetëm një shteti anëtar të BE-së. Edhe pse Komisioni do të kishte pëlqyer caktimin e pragjeve më të ulëta se ato të Nenit 1 (2), u arrit kompromisi që konsistoi në shtesën e Nenit 1 (3).

Ky nen përcakton se përqendrimi i cili nuk arrin pragjet e vendosura në Nenin 1 (2) ka një dimension European kur: (a) xhiroja totale në nivel botëror e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse në përqendrim është më e madhe se 2,500 milion Euro; (b) në secilin prej të paktën tre shteteve anëtare, xhiroja totale e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse në përqendrim është më e madhe se 100 milion Euro; (c) në secilin prej të paktën tre shteteve anëtare të përmendura në pikën (b), xhiroja totale e realizuar në mënyrë individuale nga të paktën dy ndërmarrje pjesëmarrëse në përqendrim është më e madhe se 25 milion Euro; dhe (d) xhiroja totale e realizuar individualisht brenda BE-së nga të paktën dy ndërmarrje pjesëmarrëse në përqendrim është më e madhe se 100 milion Euro, përveç rasteve kur secila nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim krijon më shumë se dy të tretat e xhiros totale në BE, brenda vetëm një shteti anëtar të BE-së.

Në krahasim me marrëveshjet e ndaluara sipas shtyllës së parë të së drejtës Europiane të Konkurrencës, bashkimet e shoqërive krijojnë efekte më të qëndrueshme dhe afatgjata brenda tregut.³² ECMR-ja dhe Neni 3 (1) (b) i saj e përkufizojnë ndryshimin e kontrollit bazuar në qëndrueshmërinë e tij. Ky nen e përshkruan përqendrimin si një situatë ku kemi ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit të një ndërmarrjeje apo një pjese të saj e cila vjen si rrjedhojë e (i) bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura ose pjesëve të tyre; (ii) përfitimit të

²⁸ Facebook/WhatsApp Inc, Case COMP/M.7217, Komisioni European, C(2014)7239 përfundimtare.

²⁹ Shih gjithashtu: Meyer, Jan HF, dhe Ray Land. "Threshold concepts and troublesome knowledge." Overcoming barriers to student understanding: Threshold concepts and troublesome knowledge (2006): 3-18.

³⁰ "ECMR", rëfimi 8.

³¹ Një përkufizim mbi 'xhiron vjetore' është dhënë në pikën 124 të Njoftimit Juridiksional, Njoftimi Juridiksional i Komisionit të Konsoliduar sipas Rregullores së Këshillit (EC) r 139/2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet palëve (2008/C 95/01)

³² Hüschelrath, Kai, dhe Florian Smuda. "Do cartel breakdowns induce mergers? Evidence from EC cartel cases." Revista Evropiane e Konkurrencës 9, nr. 2 (2013): 407-429.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL

◆ Numri 4

Nëntor 2017

kontrollit nga një person ose ndërmarrje mbi një ndërmarrje tjetër, mbi një pjesë të saj apo mbi asetet e saj dhe (iii) krijimin e një sipërmarrje të përbashkët me funksione të plota (*full function joint-venture*). Si rrjedhojë përqendrimi mund të lindë si pasojë e bashkimit të dy shoqërive më parë të pavarura ose si pasojë e ndryshimit të kontrollit³³ të një shoqërie ekzistuese³⁴.

Në rastin e analizuar në këtë shkrim, rastin e Facebook-ut, ndodhemi përpara kategorisë së dytë, përfitimit të kontrollit³⁵. Kontrolli përkufizohet nga Neni 3 (2) i ECMR-së si mundësia për të ushtruar një ndikim vendimtar mbi një ndërmarrje. Megjithatë nuk është e nevojshme të provohet se ndikimi vendimtar është ushtruar. Kontrolli mund të përfitohet me anë të të drejtave, kontratave ose me mënyra të tjera, të cilat krijojnë mundësinë e ushtrimit të një ndikimi vendimtar mbi një ndërmarrje, në veçanti me anë të: (a) së drejtës së pronës ose të së drejtës për të përdorur të gjitha ose një pjesë të aktiveve të një ndërmarrjeje dhe (b) të drejtave ose kontratave, që japin një ndikim vendimtar mbi përbërjen, votimin ose vendimet e organeve drejtuese të një ndërmarrjeje³⁶. Mënyra se si FB kontrollonte WhatsApp-in nuk përbënte shqetësim në vetvete, pasi Komisioni e miratoi transaksionin duke dalë në përfundimin se ky transaksion nuk krijonte efekte antikonkurrenshme në treg. Në të njëjtën kohë për shkak të mungesës së juridiksionit³⁷, Komisioni refuzoi të diskutonte mbi 'kontrollin' e të dhënave private që është thelbi i shtyllës së mbrojtjes së konsumatorit.

IV. INFORMACIONE TË PASAKTA OSE MASHTRUESE – RASTI I FACEBOOK-ut

Që me hyrjen në fuqi të ECMR-së në vitin 2004, rasti i Facebook-ut³⁸ është konsideruar si vendimi i parë me anë të të cilit Komisioni vendosi gjoba për dhënien e informacioneve të pasakta ose mashtruese bazuar në nenin 14 (1). Në të kaluarën, të gjitha vendimet e këtij lloji merreshin në kuadër të ECMR-së së vjetër e cila parashikonte rregulla të ndryshme për përcaktimin e gjobave³⁹. Neni 4 i ECMR-së parashikon qartësisht se ndërmarrjet janë të detyruara të japin informacion të saktë përgjatë procesit të njoftimit si dhe në të gjitha procedurat e tjera të paraqitjes së dokumentacionit⁴⁰. Ndërmarrjet duhet të japin informacione të sakta dhe jo mashtruese sepse kjo është thelbësore për t'i mundësuar Komisionit të kryejë në mënyrë efektive dhe në kohë⁴¹ vlerësimin e bashkimit të shoqërive. Paragrafi 1 i Nenit 4 përcakton në mënyrë të

³³ Shih gjithashu: mbi rëndësinë e 'kontrolleve', Jones, Alison, dhe Brenda Sufrin. *EU competition law: text, cases, and materials*. Oxford university Press, 2016, faqe 1085.

³⁴ Shih: Cook, C. John, dhe Christopher Stephen Kerse. *EC merger control*. Vëllimi. 3. Sweet & Maxwell, 1996.

³⁵ Angwin, Duncan. "Mergers and acquisitions across European borders: National perspectives on pre-acquisition due diligence and the use of professional advisers." *Revista e Biznesit Botëror* 36, nr. 1 (2001): 32-57.

³⁶ Njoftimi Juridiksional i Komisionit të Konsoliduar sipas Rregullores së Këshillit (EC) Nr 139/2004 mbi kontrollin e përqendrimeve të ndërmarrjeve (2008/C 95/01) njohur si Njoftimi i Juridiksionit pika 16

³⁷ Tucker, Darren S., dhe Hill B. Wellford. "Big mistakes regarding big data." (2014).

³⁸ FB/WhatsApp Inc, Çështja COMP/M 7217, EC C(2014) 7239 përfundimtare. Shih gjithashu: C.R. Sunstein, *Divided Democracy in the Age of Social Media*, Princeton University Press, 2017.

³⁹ Rregullorja e Këshillit (EEC) 4064/89 (OJ 1989 L395/1, 30.12.1989), Shih gjithashu: Vendimi i Komisionit, *Bertelsmann/Kirch/Premiere (1999/153/EC)*, Maj 27, 1998 [1999] O.J. L53/1.

⁴⁰ "ECMR" Neni. 4.

⁴¹ *Ibid.* Neni 4(1), Afati i mëparshëm i njoftimit brenda 7 ditëve pas arritjes së një marrëveshjeje bashkimi u hoq me



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL ♦ Numri 4

Nëntor 2017

detajuar detyrimin e ndërmarrjeve për të njoftuar Komisionin përpara zbatimit të një marrëveshjeje dhe në vijim pas lidhjes së një marrëveshjeje. Sipas të njëjtit nen, njoftimi duhet gjithashtu të kryhet kur një ndërmarrje e interesuar është në gjendje t'i provojë Komisionit vullnetin në mirëbesim për të lidhur një marrëveshje apo një tjetër marrëdhënie të ligjshme, me kusht që kjo marrëdhënie do të krijojë një përqendrim me dimension Europian. Për qëllim të ECMR-së termi 'përqendrim i njoftuar' do të mbulojë gjithashtu përqendrimet e planifikuara dhe të njoftuara në përputhje me paragrafin e dytë⁴².

Për të kuptuar më mirë rastin e FB-së, duhen analizuar ndodhitë e vitit 2014 kur FB-ja njoftoi Komisionin mbi blerjen e WhatsApp-it. FB-ja pretendoi se e kishte të pamundur të realizonte një përputhje automatike të besueshme me llogaritë e përdoruesve të WhatsApp-it. Kjo do të thotë se një nga pyetjet që iu drejtuan FB-së ishte nëse është e mundur që të ekzistojë një lidhje midis numrave të telefonit të konsumatorëve të WhatsApp-it dhe identitetit të konsumatorëve të FB-së që mundëson shpërndarjen e të dhënave të konsumatorëve. FB-ja iu përgjigj negativisht të gjitha pyetjeve në lidhje me këtë çështje. Gjatë shqyrtimit të bashkimit, FB-ja informoi Komisionin se përputhshmëria automatike e të dhënave midis llogarive të FB-së dhe WhatsApp-it nuk ishte as e mundur dhe as e dëshirueshme. Si FB-ja nëpërmjet FB Messenger ashtu edhe WhatsApp-i ofrojnë aplikacione për telefonat smart të quajtur "Aps"⁴³. Kjo ishte arsyeja përse Komisioni miratoi në mënyrë të pakushtëzuar bashkimin me WhatsApp-in (dha dritën jeshile) pas një shqyrtimi me një fazë. Me fjalë të tjera në vitin 2014 Komisioni autorizoi bashkimin e propozuar mes WhatsApp Inc. dhe Facebook Inc., (e njëjta gjë u bë dhe nga autoritetet amerikane), të dyja shoqëri me origjinë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe të dyja me veprimtari si në SHBA ashtu edhe në tregun Europian⁴⁴. Komisioni arriti në përfundimin se FB Messenger dhe WhatsApp-i nuk janë konkurrentë të afërt dhe se konsumatorët do të vazhdonin të kishin një sërë alternativash⁴⁵.

Hetimi i Komisionit u përqendrua në tre fusha të lidhura me produktin e tregut: Shërbimet e Komunikimit të Konsumatorit (SHKK); Shërbimet e Rrjeteve Sociale (SHRRS); dhe Shërbimet e Reklamave Online (SHRO). Përsa i përket SHKK-ve Komisioni arriti në përfundimin se FB Messenger dhe WhatsApp-i nuk ishin konkurrentë të afërt dhe se konsumatorët do të vazhdonin të kishin një mundësi të gjerë zgjedhesh. Megjithëse bashkimi ka efekte në tregun e aplikacioneve të komunikimit të konsumatorëve, në rastin konkret nuk ka gjasa, që entiteti i

reformën e 2004.

⁴² Ibid. Neni. 4(2).

⁴³ 'Apps' u mundëson përdoruesve të komunikojnë me anë të teksteve, pikturave/fotove, mesazheve zanore apo video.

⁴⁴ Ellerbrok, Ariane. "Empowerment: analyzing technologies of multiple variable visibility." *Surveillance & Society* 8, nr. 2 (2010): 200-220. Shih gjithashtu: Perez-Vega, Rodrigo, Kathryn Waite, dhe Kevin O'Gorman. "Social impact theory: An examination of how immediacy operates as an influence upon social media interaction in Facebook fan pages." *The Marketing Review* 16, nr. 3 (2016): 299-321.

⁴⁵ Deklaratë për shtyp mbi Bashkimet: Komisioni miraton blerjen e WhatsApp nga Facebook.; http://europa.eu/rapid/press-release_IP-14-1088_en.htm, Bruksel, 3 Tetor 2014.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL

◆ Numri 4

Nëntor 2017

bashkuar të jetë i mbrojtur nga konkurrenca e aplikacioneve të tjera ekzistuese apo të reja⁴⁶. Së dyti, në lidhje me SHRRS-në Komisioni arriti në përfundimin se, pavarësisht kufirit të saktë ndarës të tregut të shërbimeve të rrjeteve sociale, dhe pavarësisht faktit nëse WhatsApp-i konsiderohet apo jo një rrjet social, dy shoqëritë janë konkurrenca të largëta. Bazuar në numrin e përdoruesve (mujorë), FB-ja konsiderohet si rrjeti më i madh social i cili lidh 2 miliard përdorues në të gjithë botën ndërsa WhatsApp-i renditet i pesti. Ata nuk konsiderohen si konkurrentë potencialë në tregun e SHRRS-ve duke qenë se kryejnë funksione të ndryshme⁴⁷. Së fundmi, në lidhje me SHRO-të, Komisioni arriti në përfundimin se pavarësisht nëse FB-ja do të përfshinte reklama në Whats-App dhe/ose do të niste mbledhjen e të dhënave të përdoruesve të Whats-App-it për qëllime reklamimi, përsëri transaksioni nuk krijonte shqetësime në fushën e konkurrencës⁴⁸. Arsyeja ishte se përveç FB-së, ekzistonin disa ofrues alternativë të shërbimit, të cilët do të vazhdonin të ofronin shërbimin e reklamave edhe pas këtij transaksioni dhe se do të vazhdonin të ekzistonte një numër i madh të dhënash të përdoruesve të internetit, të dobishme për qëllime reklamimi, jashtë kontrollit të FB-së.

Aktualisht WhatsApp-i nuk mbledh të dhënat e përdoruesve të vlefshme për qëllime reklamimi⁴⁹. Gjatë kryerjes së vlerësimit konkurrueshmërisë të të gjitha këtyre shërbimeve, Komisioni hamendësoi edhe situatën ku përputhshmëria automatike e të dhënave të përdoruesve do të ishte e mundur. Vendosi se edhe në një rast të tillë përfundimi i arritur më parë, i mungesës së efekteve të antikonkurueshmërisë të transaksionit të propozuar, do të ishte sërish i vlefshëm⁵⁰. Përsa i përket çështjes së mbrojtjes së të dhënave (privacy) që rrjedh nga rritja e përqendrimit të të dhënave, vendimi i Komisionit thekson se kjo çështje nuk është objekt i legjislacionit Europian të mbrojtjes së Konkurrencës⁵¹.

Vlen për tu përmendur se kundërshtarët e procesit të përqendrimit të FB-së dhe WhatsApp-it, ngritën përpara Komisionit shqetësimin se përdorimi i të dhënave mes FB-së dhe WhatsApp-it ishte i mundur, një çështje kjo që konsiderohet mjaft e nxehtë në BE-në e ditëve të sotshme⁵². Disa autorë mendojnë se të dhënat në vetvete nuk janë të mira apo të këqija por përdorimi dhe kontrolli i tyre mund të dobësojnë konkurrencën së bashku me mbrojtjen e konsumatorit⁵³.

⁴⁶ FB/WhatsApp Inc, Cështja COMP/M 7217, EC C(2014) 7239 përfundimtare, pikat. 127-134.

⁴⁷ Ibid. pika. 158.

⁴⁸ Giovanni Pitruzzella, *Big Data and Antitrust Enforcement*, Revista Italian di Antitrust, N.1 2017, Shih gjithashtu: Së bashku me Google, FB është një nga kanalet më të mëdha për marketingun online: https://blog.lexicata.com/get-more-law-firm-reviewsonline/?utm_campaign=shareaholic&utm_medium=linkedin&utm_source=socialnetwor

⁴⁹ FB/WhatsApp Inc, Cështja COMP/M 7217, EC C(2014) 7239 përfundimtare (pikats.165-7).

⁵⁰ Yaghoubi, Reza, Stuart Locke, dhe Jenny L. Gibb. "Sources of Value in Mergers and Acquisitions." (2013), fq. 7.

⁵¹ FB/WhatsApp Inc, Cështja COMP/M 7217, EC C(2014) 7239 përfundimtare, (pika. 164).

⁵² Boutin, Xavier, dhe Georg Clemens. "Defining 'Big Data' in Antitrust." (2017).

⁵³ Ezrachi, Ariel. *EU competition law: an analytical guide to the leading cases*. Bloomsbury Publishing, 2016, fq. 454. Shih gjithashtu: Trattner, Marina. "Assessment of anti-innovative mergers in high technology markets. What kind of substantive test should be done to protect innovation?." (2016).



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL ♦ Numri 4 Nëntor 2017

Çështja kryesore është se mbrojtja e konsumatorit është e lidhur ngushtësisht me përdorimin dhe kontrollin e të dhënave (privacy) të zotëruara nga ndërmarrje të tilla si Facebook-u dhe WhatsApp-i⁵⁴. Megjithatë mbrojtja e të dhënave personale konsiderohet si një çështje që ka të bëjë me aspektin thelbësor të bashkimit të shoqërive dhe jo me vlerësimin procedural siç është rasti konkret i shqyrtuar në këtë shkrim⁵⁵. Çuditërisht, në rastin konkret Komisioni e nënçmoi vlerën e vërtetë të të dhënave, megjithëse FB-ja bleu WhatsApp-in kundrejt një çmimi prej 19 miliard USD në një kohë kur raportonte humbje neto prej miliona dollarësh. Fakt ky, i cili të bën të mendosh se të dhënat në kohë reale ishin përfshirë në çmimin e shitjes.

Në Korrik të vitit 2016 një palë e tretë i dërgoi Komisionit një dokument sipas të cilit ndërmarrjet palë të përqendrimit mbanin korrespondencë në lidhje me llogaritë e përdoruesve. Në këtë kohë, WhatsApp-i njoftoi ndryshime të termave dhe kushteve të shërbimit dhe të politikave të mbrojtjes së të dhënave të përdorura prej tij, përfshirë mundësinë për të lidhur numrat e telefonit të konsumatorëve të WhatsApp-it me identitetin e konsumatorëve të FB-së⁵⁶. Komisioni i dërgoi FB-së një “*Deklaratë Kundërshtimesh*” duke përshkruar në mënyrë të detajuar shqetësimet e tij në lidhje me shkeljet e mundëshme të ECMR-së⁵⁷. Hetimi zbardhi faktin se mundësia teknike për përputhshmërinë automatike të identitetit të përdoruesve të FB-së dhe WhatsApp-it ekzistonte që në vitin 2014 dhe se dy herë rresht Komisioni kishte marrë informacione mashtruese, si në formularin e njoftimit ashtu edhe në kërkesën për përgjigje. Komisioni vendosi se FB-ja ishte në shkelje të detyrimit për të dhënë informacione të plota dhe të sakta dhe se kjo shkelje ishte rrjedhojë e pakujdesisë.

Komisioni kishte kryer gjithashtu një vlerësim alternativ (*edhe nëse*), i cili merrte si të mirëqënë që përputhshmëria e të dhënave të përdoruesve të ishte e mundur. Është me rëndësi të përmendet se edhe Drejtori i Komisioni Federal të Tregtisë dhe Zyra e Mbrojtjes së Konsumatorit të SHBA-së nënvizuan në letrën dërguar palëve të përqendrimit se këto të fundit duhet të vazhdonin të respektonin mbrojtjen e të dhënave të konsumatorëve⁵⁸.

⁵⁴ FB/WhatsApp Inc, Çështja COMP/M 7217, EC C(2014) 7239 përfundimtare, (pika 164).

⁵⁵ Sokol, D. Daniel, dhe Roisin E. Comerford. "Does antitrust have a role to play in regulating big data?." (2016).

⁵⁶ Botros, M, *Privacy Rights in the Age of Social Media: Facebook Passwords and Legal Implications*, Law school Student Scholarship, eRepository, 2013, Shih gjithashtu: Natasha Lomas, WhatsApp to share user data with Facebook for ad targeting here's how to opt out, 25 Gusht 2016, <https://techcrunch.com/2016/08/25/whatsapp-to-share-user-data-with-facebook-for-ad-targeting-heres-how-to-opt-out/>, Shih gjithashtu: Lindsay S. Feuer, 'Who is Poking Around Your FB Profile? The need to reform the stored Communications Act to React a Lack of Privacy on Social Networking Websites' Hofstra Law Review, Vëllimi 40. ICështja 2 Fortieth Anniversary Volume, 2011.

⁵⁷ Komisioni Europian ka dërguar një Deklaratë Kundërshtimi Facebook-ut ku pretendon se kompania ka ofruar informacione të pasakta ose mashtruese gjatë hetimit të Komisionit në vitin 2014 sipas Rregullores së Bashkimit Europian mbi blerjen e planifikuar të WhatsApp-it nga Facebook-u, Bruksel, 20 Dhjetor 2016, http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16-4473_en.htm

⁵⁸ Komisioni Federal i Tregtisë për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Amerikës, FTC njofton FB-në, WhatsApp-in për Detyrimet e Privatësisë në dritën e Blerjes së Propozuar, e aksesueshme në: <https://www.ftc.gov/news-events/press-releases/2014/04/ftc-notifies-facebook-whatsapp-privacy-obligations-light-proposed>.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL

◆ Numri 4

Nëntor 2017

Vendimi i fundit ndaj FB-së nuk ka impakt në Vendimin e Komisionit të Tetor 2014-tës për autorizimin e transaksionit sipas ECMR-së. Megjithatë vendimi është i rëndësishëm për këto arsye: së pari, ky është vendimi i parë që vendos gjobë mbi një shoqëri sipas rregullores së re të ECMR-së për dhënien e informacioneve të pasakta dhe të paplota⁵⁹; së dyti ai përmban rekomandimin që çështja të shqyrtohet edhe në kuadër të shkeljeve potenciale të mbrojtjes së të dhënave personale, megjithatë vendimi thekson shprehimisht se ky lloj shqyrtimi është jashtë objektit të së drejtës së konkurrencës; së treti, për shkak të bashkëpunimit të FB-së gjatë hetimeve, Komisioni e përgjysmoi gjobën fillestare. Mbetet e paqartë nëse kjo do të përbëjë një praktikë të përdorshme në çështjet e ardhshme apo do të shërbejë më shumë si mjet parandalues për shoqëritë e tjera të tregut.

Së fundmi dhe shumë shkurtimisht duhet të përmendet se një nga detyrat kryesore të Komisionerit është të garantojë zbatimin e të drejtës europiane dhe të mbrojtë interesin e përgjithshëm të BE-së⁶⁰. Megjithatë, për shkak të ngjyimeve politike kjo nuk është gjithmonë një detyrë e lehtë⁶¹. Sipas intervistës të lëshuar nga Vestager-i në lidhje me Vendimin e Komisionit për Facebook-un duket se Komisioni ka marrë një qëndrim më të vendosur për të ndaluar shkeljet e ECMR-së nga 'Peshkaqenët' e mëdhenj. Është në kompetencën e Komisionerit të përpiket të qetësojë situatat e nxehta ndërsa ndërmarrjet e bashkuara shkelin rregullat e bashkimit të shoqërive, por këto të fundit duhet në të njëjtën kohë të jenë tërësisht të kujdesshme që të mos djegin duart e tyre⁶².

V. GJOBAT

Sipas Nenit 14 (1) të ECMR-së, Komisioni mund të vendosë një gjobë maksimale deri në 1% të xhiros totale për sjelljen e qëllimshme ose të pakujdesshme të dhënies së informacioneve të

⁵⁹Së shpejti pasuan vendime të tjera. Në korrik 2017 KE-ja dërgoi një deklaratë kundërshtimi ndaj 'General Electric' Merck dhe Canon për ofrimin e informacionit të pasaktë gjatë operacioneve të tyre të bashkimit. Komisioni ka dërguar tre deklarata të veçanta të kundërshtimeve për Merck dhe Sigma-Aldrich, General Electric dhe Canon duke pretenduar se kanë shkelur rregullat e bashkimit të BE-së: General Electric, dhe Merck dhe Sigma-Aldrich për ofrimin e informacioneve të pasakta ose mashtruese; Canon duke realizua një bashkim përpara njoftimit dhe qartësisë: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-17-1924_en.htm, Bruksel, 6 Korrik 2017.

⁶⁰Neni 17 i Traktatit për Bashkimin Evropian (TEU), nenet 234, 244 deri 250, 290 dhe 291 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe Traktatin për Krijimin e një Tregu të Vetëm.

⁶¹Ky Komision është më shumë i fokusuar te zbatimii duhur i "ECMR"-së sesa Komisioni i mëparshëm Shih gjithashtu: Drauz, Gotz, Thomas Chellingsworth dhe Hertta Hyrkas. "Recent Developments in EC Merger Control." "Revista për Ligjin e Konkurrencës Evropiane & PraktikaJ 1, nr. 1 (2009): 26.

¹⁸⁴Eleanor M. Fox, Walter J. Derenberg Profesoreshe në të Drejtën Tregtare pranë New York University School of Law, International Economic Law Trade, *Developing Countries, Markets and Competition Laws: How Developing Countries Are Trying to Improve Their Economic Wellbeing by Harnessing Markets to Work for Them*. Diskutimi i saj është i mundur në Librarinë Audivzuale mbi Ligjin Ndërkombëtar të OKB-së: http://legal.un.org/avl/ls/Fox_E_IEL.html#.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL

◆ Numri 4

Nëntor 2017

pasakta apo mashtruese⁶³. Gjatë përcaktimit të masës së gjobës ndaj Facebook-ut, Komisioni theksoi natyrën e rëndë të shkeljeve. U deklarua se për shkak të mungesës së të gjitha informacioneve me vlerë për shqyrtimin e transaksionit, Komisioni nuk ishte në gjendje të kryente një hetim të përshtatshëm. Paligjshmëria vinte si pasojë e fshehjes nga FB të fakteve për të cilat ishte në dijeni ose duhet të kishte qenë në dijeni, duke pasur parasysh se njohuria është një detyrë, veçanërisht për shkak të rëndësisë së çështjes së përputhshmërisë së të dhënave. Megjithatë për shkak të bashkëpunimit gjatë hetimeve dhe pranimit të shkeljes së ECMR-së, Komisioni vendosi zvogëlimin e masës së gjobës⁶⁴.

FB-ja kreu dy shkelje duke dhënë informacione të pasakta dhe mashtruese në formularin e njoftimit të bashkimit të shoqërive dhe në përgjigjen ndaj kërkesës për informacion të Komisionit. Komisioni konsideroi se këto shkelje janë të rëndësishme sepse e penguan atë të kishte informacionet e duhura për shqyrtimin e transaksionit. Xhiroja totale e regjistruar në vitin 2016 ishte 28 miliard Euro, por Komisioni mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe zvogëloi masën e gjobës: 55 milion Euro për dhënien e informacioneve mashtruese në formularin e njoftimit dhe 55 milion Euro për dhënien e po të njëjtave informacione mashtruese në përgjigjen ndaj kërkesës së Komisionit. Si rrjedhojë, shkelja e detyrimeve procedurale eFB-së u konsiderua të paktën si pakujdesi. Komisioni theksoi se gjoba totale prej 110 milion Euro është proporcionale si dhe ka efekte parandaluese. Vendosija e gjobës nuk ndryshonte vendimin e Komisionit mbi miratimin e blerjes së WhatsApp-it dhe nuk ndikohej nga hetime të veçanta në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

VI. RASTI I FACEBOOK-ut DHE E DREJTA E KONKURENCËS NË SHQIPËRI DHE MAQEDONI

Të dy ligjet për mbrojtjen e konkurrencës në Shqipëri dhe Maqedoni dhe përkatësisht Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës në Shqipëri⁶⁵ (LMKSh) dhe Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës në Maqedoni⁶⁶ (LMKM) përcaktojnë rregullat për kontrollin e bashkimit të shoqërive në përputhje me ECMR-në, si një parakusht të statusit të tyre si vende kandidatë të BE-së⁶⁷. Duke qenë se

⁶³Paragrafi 1 i nenit 14 thekson që: "KE vendos mbi personat e përmendur në nenin 3 (1) b, ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve, gjoba që nuk tejkalojnë 1% të xhiros totale të ndërmarrjes ose shoqatës së ndërmarrjeve në kuptim të nenit 5 kur, me dashje ose nga neglizhenca: (a) japin informacione të pasakta ose mashtruese në një paraqitje, certifikim, njoftim ose plotësim të tyre, sipas Nenit 4, Neni 10 (5) ose Neni 22 (3) .

⁶⁴ Vestager informoi se Komisioni është shumë i zënë me hetimin e një numri të shkeljeve të ngjashme dhe gjoba të tjera do të vijë gjithashtu. Këto zhvillime rrjedhin nga një hetim paraprak për mbi mundësinë e ofrimit të informatave mashtruese nga Munksjo dhe Ahlstrom. Ky rast u dallua nga mospërputhjet midis vlerësimeve të aksioneve të tregut të dhëna në formën CO Shih Cështjen M.6576-Munksjo / Ahlstrom.

⁶⁵ Ligji Nr. 9121, datë 28.07. 2003, "Për mbrojtjen e Konkurrencës". (LMKSH)

⁶⁶ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, Gazeta Zyrtare 145/10, Republika e Maqedonisë. (LMKM)

⁶⁷Raporti i Komisionit European për Shqipërinë, 2016: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf.

⁶⁷ Raporti i Komisionit European për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2016 : <https://ec.europa.eu/neighbourhood->



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL

Numri 4

Nëntor 2017

rregullat mbi informacionet e pasakta dhe mashtruese janë gjithashtu të përcaktuara në legjislacionin e të dyja vendeve (Shqipërisë dhe Maqedonisë) praktika e ndjekur nga Komisioni në çështjen e Facebook-ut përbën një praktikë të dobishme ligjore që mund të merret si bazë për interpretimin e dispozitave ligjore përkatëse në këto dy vende Kandidate. Kjo gjithashtu në kuadër të faktit se e drejta europiane e konkurrencës, si pjesë e *EU Acquis* ka efekt të drejtpërdrejtë dhe duhet të miratohet dhe zbatohet nga të dyja vendet gjatë rrugës së tyre drejt integritimit Europian. Në rast se shqyrtohen dispozitat specifike të legjislacionit të konkurrencës së Shqipërisë dhe Maqedonisë është e dukshme se kjo bazë ligjore përfshihet në legjislacionin e brendshëm. Të dyja legjislacionet parashikojnë rregulla në lidhje me informacionin e pasaktë ose mashtrues gjatë njoftimit të një përqendrimi siç ishte edhe në rastin e FB-së.

Përkatësisht LMKSh-ja bën dallimin mes shkeljeve 'të rënda' dhe shkeljeve 'të lehta'. Neni 73 (1) (a) i ndodhur në Pjesën VI të LMKSh-së mbi Kundërvajtjet Administrative dhe Sanskionet, përcakton gjobat për 'shkeljet e lehta'. Ky nen përcakton se ndërmarrjet të cilat japin informacione të pasakta apo mashtruese në përgjigje të një kërkesë të bërë apo vendimi të marrë në përputhje me nenet 12 dhe 33 të këtij ligji, ose japin informacione dhe dokumente shtesë të pasakta dhe të paplota sipas nenit 55 të këtij ligji, do të ndëshkohen. Në këto raste Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës (ASHK) parashikon gjoba që nuk e tejkalojnë masën prej 1% të xhiros totale të vitit financiar paraardhës. Neni 12 (3) (b) përkufizon përqendrimin me anë të përfitimit të kontrollit dhe kuptimin e konceptit të kontrollit. Ky përkufizim është gati në të njëjtën linjë me ECMR-në. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në një përqendrim janë të detyruara t'i japin autoritetit kompetent⁶⁸ informacionin e kërkuar. Në rast se këto ndërmarrje japin informacione të paplota, autoriteti kompetent për konkurrencën mund të kërkojë informacionin e nevojshëm me anë të një vendimi⁶⁹. Sipas paragrafit 4 të po të njëjtit nen, në asnjë rast ndërmarrjet nuk mund të refuzojnë t'i japin autoritetit informacionet edhe në rast se ato mbulohen nga sekreti tregtar⁷⁰. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim kanë gjithashtu detyrimin t'i japin autoritetit informacione dhe dokumente shtesë për kryerjen e vlerësimit të përqendrimit⁷¹.

Nga ana tjetër Ligji⁷² në Maqedoni përcakton masën e gjobës që do të zbatohet ndaj ndërmarrjeve në proces përqendrimi të cilat i paraqesin Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës informacione të pasakta apo mashtruese. Ligji parashikon se për rastet e shkeljeve, Komisioni do të vendosë gjobën në masën 1% të xhiros totale vjetore, kur jepen informacione të pasakta ose mashtruese në njoftimin e përqendrimit dhe anekset e tij si dhe së bashku me të dhënat shtesë. Nga shqyrtimi i neneve kryesore të LMKM-së është e lehtë të arrihet në

[enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf](#).

⁶⁸ Ibid. Neni 33 (1).

⁶⁹ Ibid. Neni 33(2).

⁷⁰ Ibid. Neni 33(4).

⁷¹ Ibid. Neni 55(1).

⁷² "LMKM", Neni 61.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL

◆ Numri 4

Nëntor 2017

përfundimin se ky ligj dhe në veçanti seksioni i tij i krijuar në përputhje me ECMR-në përcakton padyshim dhe shprehimisht rregullat mbi informacionet e pasakta dhe mashtruese.

Të dyja ligjet përcaktojnë gjoba për shkeljet e sipërpërmendura në masën që nuk e tejkalon 1% të xhiros totale, gjë që mund të përbëjë temë diskutimi në të ardhmen duke marrë parasysh përmasat dhe efektivitetin e tregjeve përkatëse.

VII. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Veprimtaria e Komisionit Europian e analizuar në këtë shkrim është një sinjal i fortë për të gjithë palët e interesuara se rregullat procedurale europiane të bashkimit të shoqërive duhet të respektohen në Shtetet Anëtare të BE-së⁷³. Gjoba që Komisioni vendosi ndaj Facebook-ut mund të përbëjë një mësim jo vetëm për këtë të fundit por edhe për të gjitha ndërmarrjet të cilat shkelin rregullat procedurale të bashkimit të shoqërive dhe një shenjë që të mos shpërfilllet fakti se përdorimi dhe kontrolli i të dhënave mund të dobësojë të drejtën e konkurrencës dhe të krijojë shqetësime të tjera në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e konsumatorit⁷⁴.

Për më tepër, vendimi i Komisionit mund të ketë efekte edhe për shtetet Kandidate të cilat aktualisht nuk janë Shtete Anëtare të BE-së, si Shqipëria dhe Maqedonia, gjatë procesit të tyre të harmonizimit të legjisllacionit të konkurrencës me *EU Acquis*. Në mënyrë që këto vende të përmbushin detyrimin e përafritimit me *EU Acquis*, rregullat e tyre mbi bashkimin e shoqërive dhe kontrollin duhet të rishikohen dhe të përditësohen në mënyrë pasqyrimin e zhvillimeve të fundit dhe vendimeve të Komisionit. Veçanërisht duke marrë parasysh se Facebook-u ushtron gjithashtu veprimtarinë e tij në këto vende Kandidate si dhe në vende të tjera Kandidate potenciale⁷⁵ të BE-së, vendimi i fundit i Komisionit mund të shërbejë si bazë për harmonizimin e *EU Acquis* edhe në këtë fushë

⁷³ Jia Lynn Yang, *Dangerous Waters? FB's Link to Online Games Has Some Charging the Social Network has waded into Antitrust Territory*, Daily Herald CH, 30 Qershor 2011.

⁷⁴ Ezrachi, Ariel. *EU competition law: an analytical guide to the leading cases*. Bloomsbury Publishing, 2016, fq. 452. Shih gjithashtu: Costa-Cabral, Francisco, dhe Orla Lynskey. "The internal and external constraints of data protection on competition law in the EU." *Revista Elektronike SSRN* (2015). Shih gjithashtu, Stucke, Maurice E., dhe Allen P. Grunes. "Debunking the myths over big data and antitrust." (2015).

⁷⁵ Bosnja & Hercegovina dhe Kosova konsiderohen shtete kandidat potenciale dhe futja e tyre në BE do të realizohet kur të jenë gati.